



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2022:210460

Datë: 31.05.2023

Numri i dokumentit: 04346925

PKR.nr.26/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-Departamenti për krime të rënda, me Kryetaren e trupit gjykues Violeta Husaj Rugova, me pjesëmarrjen e procesmbajtëses Bute Ramosaj, në çështjen penale ndaj të akuzuarit B.K. nga fshati M., K. P., për vepër penale, “posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.2 lidhur me nenin 275 par.1 nën par. 1.8 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë, Departamenti për krime të rënda PP/I.nr.275/2022 të datës 13.02.2023, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në prezencë të Prokurorit të shtetit Agron Galani të akuzuarit B.K. si dhe mbrojtësi i tij av. Xhemajl Ademaj nga Prishtina sipas autorizimit, me datë 29.05.2023 mori dhe shpalli, si dhe me datë 31.05.2023 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

B.K., i lindur me datë, në P., me vendbanim në fshatin M., K. P., i biri i L. dhe i nënës R. e gjinisë G., i pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së dobët ekonomike, me numër personal, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës gjendet në vuajtje të dënimit për vepër penale trafikim me njerëz në kohëzgjatje prej 4 vite e 6 muaj.

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se:

Më datë 20.06.2022 duke qenë në vuajtje të dënimit në SH.K.K-Q.K në D., në Pavijonin .-J.-..., në mënyrë të paautorizuar ka poseduar substanca narkotike të llojit marihuan në peshë prej 1,87 gramëve e cila sekuestrohet nga i pandehuri, në atë mënyrë që me datë 20.06.2022 rreth orës 11,25 minuta i pandehuri kërkon nga oficeri korrektues M. A. që të ia dërgon tri cigare të dënuarit A. K. e të cilat ishin të lyera me një substancë të zezë dhe pasi të njëjtat dyshohen se përmbajnë substancë narkotike sekuestrohen nga i pandehuri, dërgohen për ekzaminim dhe pas pranimit të raportit mbi ekzaminimin e substancës së dyshuar narkotike ka rezultuar se në tri cigaret e sekuestruara nga i pandehuri është konstatuar se ato cigare janë të

lyera me substancë të lëngët e e cila substancë ka treguar pas ekzaminimit se është prezent THC dhe se të njëjtat përmbajnë THC dhe nikotinë në peshë prej 1.87 gramëve

-Me çka ka kryer veprë penale, posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.2 lidhur me nenin 275 par.1 nën par. 1.8 të KPRK-së.

Andaj gjykata duke u bazuar në dispozitat e neneve 7, 17, 21 par. 2, 38, 39, 40, 42,43, 69, 70, 71, 72 të KPRK-së, nenit 269 par.2 lidhur me nenin 275 par.1 nën par. 1.8 të KPRK-së, si dhe nenit 364 të KPPRK-së të akuzuarin e:

G J Y K O N

Për veprën si ne dispozitivin e cekur si me lart, i caktohet dënim me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti e tre (3) muaj si dhe dënim me gjobë në shumë prej 200€ (dyqind euro), të cilat dënime do të ekzekutohen më së largu në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit.

Ne qoftë se i akuzuari nuk e paguan dënimin me gjobë në afat të caktuar, atëherë i njëjti dënim do të zëvendësohet me dënim me burg duke llogaritur një ditë burgim për çdo 20 euro të gjobës.

Të akuzuarit i konfiskohet substanca narkotike në peshë të përgjithshme prej 1.87 gramëve gram e cila gjendet në ruajtje në zingjirin policorë me numër -D...-... dhe pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit e njëjta do të shkatërrohet.

I akuzuari obligohet që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30€ (tridhjetë euro), si dhe në emër të kompozimit të viktimave të krimit shumën prej 50€ (pesëdhjetë euro). Të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë, Departamenti për krime të rënda, ka ngrit aktakuzë PP/I.nr.275/2022 të datës 13.02.2023, ndaj të akuzuarit B.K. nga fshati M., K. P., për veprë penale, “posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.1 lidhur me nenin 275 par.1 nën par. 1.8 të KPRK-së.

Pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të shtetit PP/I.nr.275/2022 të datës 13.02.2023, në seancën e shqyrtimit fillestar, gjykata është bindur se i akuzuari e ka kuptuar aktakuzën dhe të akuzuarit i ka dhënë mundësinë që të deklarohen për pranimin ose mos pranimin e fajësisë.

Në këtë rast gjykata ka udhëzuar të akuzuarin për rendësin dhe pasojat e pranimit të fajësisë dhe i akuzuari B.K. pas konsultimit me mbrojtësin e tij ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, e pranon fajësinë vullnetarisht pa presion dhe pa kurrfarë ndikimi nga askush.

Mbrojtësi i të akuzuarit av.Xhemajl Ademaj ka deklaruar se i akuzuari e shprehi vullnetin që e pranon fajësinë, mirëpo e ka pa si diçka kundërthënëse pasi që pesha e narkotikut është nën 3 gram dhe është për herë të parë.

Prokurori i shtetit ka deklaruar se duke pasur parasysh se sasia e narkotikut të sekuestruar nga i akuzuari e sipas ekspertizës ka rezultuar në peshë prej 1.87 gram dhe duke pasur parasysh se nuk kemi evidencë se i akuzuari më parë ka qenë i dënuar për vepra penale nga kapitulli i narkotikëve atëherë e bënë përmirësimin e cilësimit ashtu që tani i akuzuari akuzohet për vepër penale nga neni 269 par.2 lidhur me nenin 275 par.1 pika 1.8 të KPRK-së.

Mbrojtësi i të akuzuarit av.Xhemajl Ademaj ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë.

Prokurori i shtetit ka deklaruar se duke pasur parasysh se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në mënyrë vullnetare pa ndikim nga jashtë pa shtytje dhe pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësin e tij dhe pasi i njëjti është njoftuar me privilegjet dhe pasojat e pranimit të fajësisë propozon që të aprovohet pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit, meqenëse ky pranim i fajësisë është i mbështetur edhe në provat materiale që gjenden në shkresat e lëndës e në deklarata e dëshmitarit.

Duke pasur parasysh të lartcekurat gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe ka vërtetuar se nuk ekziston ndonjë rrethanë për hudhje të aktakuzës konform nenit 248 të KPRK-së, se janë plotësuar kushtet nga neni 241 të KPRK-së, atëherë në këtë çështje nuk është zbatuar procedura e provave, por gjykata ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Andaj gjykata duke u gjendur para këtyre fakteve siç janë pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit, si dhe duke pasur parasysh provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës siç janë: raporti pozitiv i bastisjes të SH.K.K-Q.K. në D. e datës 20.06.2022 i përpiluar nga oficeri korrektues M. A., raporti iniciues disiplinor e datës 20.06.2022, deklarata e dëshmitarit M. A. e dhënë në hetuesi me datë 07.10.2022 dhe në Propkurori me datë 13.02.2023, raporti i ekspertimit të narkotikëve nën A./....-...../..-.... e datës 18.08.2022, fotot e cigareve të sekuestruara andaj gjykata erdhi në përfundim se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha elementet e veprës penale të përshkruara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e për të cilin është shpallur fajtor.

Gjykata gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk ka gjetur se ekzistojnë rrethana për përjashtimin e përgjegjësisë penale të akuzuarit, andaj i akuzuari është penalisht përgjegjës.

Lidhur me rrethanat për dënimin:

Prokurori u shtetit deklaroi se i propozon Gjykatës që me rastin e marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit si rrethana rënduese të ketë parasysh se i akuzuari është recidivist i veprave të ndryshme penale, gjersa si rrethana lehtësuese të ketë parasysh se kjo është hera e parë që i akuzuari ka kryer vepër penale nga kapitulli i narkotikëve e po ashtu si rrethanë lehtësuese të ketë parasysh pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit.

Mbrojtësi i të akuzuarit ka deklaruar se bazuar në rrethanat të cilat i ka caktuar Kodi Penal i Kosovës të merret si rrethanë lehtësuese gjendja e tij ekonomike, mbajtës i dy prindërve pleq, sasia e kufizuar ku është 1.87 gram, do të thotë nuk e kalon 3 gram si dhe i mbrojturi i tij është hera e partë që akuzohet për këtë lloj të veprës penale, pra është lloj i veprës penale të cilën ligji e njuh si vepër penale e privilegjuar, prandaj kisha me ju lut se tani e ka kushtin dhe të mbajë dënimin mbi tri vjet dhe mos ti humbet ajo e drejtë që ky ti kthehet jetës normale dhe të ndikon në socializim. Prandaj e lut gjykatën që në suazat e Kodit Penal të Kosovës ti shqiptohet një vërejtje apo të lirohet nga akuza.

I akuzuari B.K. ka deklaruar se pajtohet me deklarinimin e mbrojtësit të tij.

Duke vendosur mbi vendimin mbi dënim konform nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, gjykata i vlerësoi të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit. Nga rrethanat lehtësuese gjeti se e kanë pranuar fajësinë qysh në seancë fillestare, gjendjen e dobët ekonomike. Nga rrethanat rënduese gjeti se i njëjti është i dënuar për vepër penale të trafikimit me njerëz dhe vuan dënimin prej 4 vite e 6 muaj gjë që deklaroj vetë i akuzuari, ka në zhvillim e sipër edhe lëndë të tjera penale për vepra të ndryshme penale, gjë që rezulton nga evidenca gjyqësore si dhe nga evidenca policore që ju është referuar prokurorit.

Për veprën penale që i akuzuari është shpall fajtorë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi parashihet dënim me gjobë dhe dënim me burgim prej 3 deri në 15 vite. Mirëpo gjykata bazuar në pranimin e fajësisë të bërë në shqyrtim fillestarë e ka marrë si rrethanë veçanërisht lehtësuese, andaj gjithnjë duke u bazuar në dispozitat e nenit 71 dhe 72 par. 1 nën par. 1.3 të KPRK-së të akuzuarit i zbut dënimin me burg duke i caktuar dënimin nën kufirin e paraparë ligjorë.

Andaj gjykata duke u gjendur para këtyre rrethanave të akuzuarin e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke konsideruar se ky dënim është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë dhe është bindur se vendimi mbi dënimin do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit e që është pengimi i të akuzuarit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen si dhe në preventivën tjetër për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale konform nenit 38 të KPRK-së.

Vendimin mbi konfiskimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e gjykata e mori bazuar në nenin 275 par. 2 lidhur me nenin 269 par.3 të KPRK-së.

Vendimi mbi obligimit e të akuzuarit në paguarjen e paushallit gjyqësor u mor bazuar në nenin 449 dhe 450 të KPRK-së.

Vendimi mbi obligimin e të akuzuarit në pagesën e shumës së cekur si në dsipozitiv të këtij aktgjykimi për viktimat e krimit, u mor bazuar në nenin 39 par.1,2,3 nën par. 3.1 të Ligjit për kompensim të viktimave të krimit.

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 364 të KPPRK-së

**GJYKATA THEMELORE PEJË
DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA ,**

2022:210460, 31.05.2023

Kryetarja e trupit gjykues

Violeta Husaj Rugova

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykatë.